

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" GAL 2019" shpk

Në këtë statut :

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Me cilësin e ortakeve themelues:

Sot me date 28.10.2019,

- 1- Andi Rakipi, i biri i Ahmet, i datelindjes 26.03.1990, limdur dhe banues ne Durres, Lagja Nr.4, Rr" Skenderbeg"
- 2- Servete Kadri Balla, e bija e Kadri, e datelindjes 16.05.1960, lindur ne Mat dhe banuese ne Lagja Nr.13, Rr "Antalja" Durres, Plazh Durres
- 3- Oneda Çarçani, e bija e Kujtim, e dtl 19.10.1991, lindur ne Durres dhe banuese ne Tirane, me adresë Rr"Don Bosko", Pallatet Vizion +, Kulla 3, Ap 6/4

me vullnet të lire e të plote, mbeshtetur :

Ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" 1 ndryshuar, Ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, themelojnë një Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin "GAL 2019" shpk (me poshte e quajtur "Shoqeria")

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria " GAL 2019" shpk eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gjëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjeshëm me kontributin që ka dhënë në kapital.



Neni 3

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën : Prane mbikalimit te Shkozitet, Perbri Shkolles Profesionale " Beqir Çela", Shkozet, Durrës.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim të shumicës te ortakeve te pranishem ne mbledhje.

Neni 4

Objekti i veprimitarise

Objekti i veprimitarise se shoqerise do te jetë: Te pergatisë specialiste te larte ne fushen e studimeve te larta profesionale. Te kryeje studime, kërkime, botime ne fushen e studimeve te larta profesionale. Te kryej kualifikime shkencore, kurse te specializimit dhe te kualifikimit afatshkurter e afatgjate.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

KREU II
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(njëqind mijë) lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar ne të holla nga ortaket e shoqerise :

1-Z. Andi Rakipi eshte zoterues i 33.33 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, percaktuar kontributi ne para ne shumen 33.330 (tridhjete e tre mijë e treqind e tri dhjete) leke

2-Znj. Servete Balla eshte zoterues e 33.34 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, percaktuar kontributi ne para ne shumen 33.340 (tridhjete e tre mijë e treqind e dyzet) leke

3.Znj. Oneda Çarçani eshte zoterues i 33.33 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, percaktuar kontributi ne para ne shumen 33.330 (tridhjete e tre mijë e treqind e tri dhjete) leke

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Kontributet në para do të paguhen menjëherë. Kontributet në natyrë do ti kalojnë Shoqërisë menjëherë pas regjistrimit në QKB.

Pagesat e kontributeve në para do të kryhet në llogarinë bankare.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogelimi i kapitalit realizohet me vendim te ortakeve në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogelimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së ortakeve të thirrur për të marrë vendim rrëth këtij projekti.

Zvogelimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast mosbatimi të kérkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kérkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organet Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakeve, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënrat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10
Administrimi

Shoqeria do te drejtohet nga administratori. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne



marredhenie me te tretet dhe ka kompetanca te plota ne drejtimin e saj

Asambleja e Pergjithshme emeron si administrator **Z. Se Junior Kazazi** i biri Idril, i d't 20.09.1995, lindur dhe banuese ne Durres. Afati i emerimit eshte 1 vite, me te drejte riparteritjeje.

Neni 11
Kompetencat e Administratorit

Administratori ka te drejtë dhe detyrohet te:

- a) kryejë te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;
 - ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi te veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori eshte i detyruar te thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :
- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
 - kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve te shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshëm e te jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo te huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore te gjitha shkallevet. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar në marrëdhënie me te tretët në emër te shoqërisë, në te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me te tretët nepërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj te tretëve kur ajo provon se te tretët e dinin që akti i

administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur te tretët nuk mund ta injoronin

këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12
Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuar nga asambleja e ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pështojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëdis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Neni 13
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve vendos rrith shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humberjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fonave ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakëve te shoqerise.

Neni 17
Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund te bashkohen nëpermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, te një shoqëri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim te aksioneve apo kuotave te kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 18
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemlare me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "GAL 2019" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

ORTAKËT

Audi Recepishi

Oneida Çoreçani

Servete Bollu

